

URDHËR
Nr. 582, datë 17.9.2018

PËR DISA NDRYSHIME NË URDHËRIN NR. 185, DATË 19.4.2018, “PËR NGRITJEN E TRI QENDRAVE RAJONALE RINORE”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 377, datë 11.6.2014, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Shërbimit Kombëtar për Rininë”,

URDHËROJ:

1. Në urdhrin nr. 185, datë 19.4.2018, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:
 - a) Shkronja “b” e pikës 1, ndryshohet si më poshtë:
“b) në qytetin e Lushnjës, qarku Fier.”.
 - b) Pika 2 ndryshohet si më poshtë:
“2. Organika e qendrave rajonale rinore, Lezhë, Lushnjë dhe Elbasan të jetë sipas lidhjes 1, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.”.
 - c) Pika 3 ndryshohet si më poshtë:
“3. Numri i punonjësve për qendrat rajonale rinore, Lezhë, Lushnjë dhe Elbasan, të jetë gjithsej 12 veta.”.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Shërbimi Kombëtar për Rininë dhe qendrat rinore.
Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË**
Lindita Nikolla

Lidhja 1

ORGANIKA E QENDRAVE RINORE NË QARKUN LEZHË (QYTETI LAÇ), QYTETI LUSHNJË (QARKU FIER), QARKU ELBASAN (QYTETI ELBASAN)

Pozicioni	Kategoria	Numri
Titullari i institucionit rajonal	III–B	1
Specialist	IV–B	3

Punonjës gjithsej për secilën qendër _____ 4
Punonjës gjithsej për tri qendrat rajonale _____ 12